



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal
Mbledhja nr.52/2018
Prishtinë, më 13.12.2018, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Sala Berisha Shala, kryetare, Dardan Sejdiu, zëvendëskryetar i parë, Hykmete Bajrami, Lutfi Zharku, Muharrem Nitaj, Veton Berisha dhe Duda Balje, anëtarë.

Munguan: Adem Hoxha, zëvendëskryetar i dytë, Glauk Konjufca, Liburn Aliu dhe Memli Krasniqi, anëtarë.

Pjesëmarrës: Liridon Gashi – SEEF; Vatra Qehaja – LVV; Donika Bekteshi – KDI; Dren Ajeti – Klubi i prodhuesve; si dhe mediat.

Stafi mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina, Besim Haliti, Veton Raci dhe Nurie Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Sala Berisha Shala, kryetare e komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 10.12.2018;
3. Shqyrtimi i Vendimit të Qeverisë për emërimin e anëtarëve të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit;
4. Raportim i z.Besim Beqaj, ministër i Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, në lidhje me punën e ministrisë për këtë vit, me theks të veçantë, ndarja e fondeve dhe grandeve për start up-et dhe bizneset tjera, si dhe planifikimi i punëve për vitin e ardhshëm;
5. Të ndryshme.

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Kryetarja, njoftoi anëtarët e Komisionit se edhe pse e kemi ftuar ministrin Besim Beqaj, fillimisht ai e ka konfirmuar praninë e tij në këtë mbledhje, por dje bëri të ditur se për shkak të angazhimeve të paplanifikuara, nuk do të mund të marrë pjesë në këtë mbledhje, prandaj propozoi që të hiqet nga rendi i ditës pika e katërt.

Dardan Sejdiu, potencoi se kjo ministri lidhet me zhvillimin e ekonomik, për këtë arsye edhe e kemi ftuar ministrin Beqaj. Ai shtoi se kjo ministri shpërndan grande, prandaj duhet të shohim se si po ndikojnë këto grande në zhvillimin ekonomik, prandaj, duhet t'i përsëritet ftesa.

Rendi i ditës u miratua me ndryshimin e propozuar nga kryetarja.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 10.12.2018

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 10.12.2018, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Vendimit të Qeverisë për emërimin e anëtarëve të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit;

Kryetarja, theksoi se Qeveria e ka sjellë propozim vendimin për plotësimin e Bordit të AKP-së, ku janë propozuar Bajram Zejnullahu, kryesues, dhe Hajzer Salihu, anëtar. Ne, sqaroi ajo, në mbledhjen e kaluar e kemi shtyrë këtë pikë, për shkak se kemi marrë një letër nga Ambasada e Britanisë së Madhe në lidhje me mospjesëmarrjen e partnerit implementues për emërimin në pozita të larta drejtuese, në procesin e emërimit të anëtarëve të Bordit të AKP-së. Mirëpo, çështjen e kanë sqaruar, siç edhe e keni pa letrën e dërguar nga përfaqësuesja e Zyrës së Kryeministrit. Ajo propozoi që të votohet propozim-vendimi i Qeverisë dhe të përcillet për seancë.

Komisioni me 4 (katër) vota për dhe 3 (tri) kundër, nxori këtë:

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të emërohen kryesuesi dhe një anëtar në Bordin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit, me mandat 4 (katërvjeçar), si në vijim:

- 1. Bajram Zejnullahu, kryesues; dhe*
- 2. Hajzer Salihu, anëtar.*

4. Të ndryshme Çështjet vijuese.

Kryetarja, njoftoi anëtarët e Komisionit se ka marrë një letër nga KOSTT-i, të cilët kanë kërkuar që të përshpejtohet zgjedhja e anëtarëve të bordit të KOSTT-it. Ajo rikujtoi se ne si Komision kemi formuar një panel për intervistimin e kandidatëve për anëtarë të Bordit të KOSTT-it. Partneri britanik, ka theksuar se nuk kanë kohë që intervistimi të bëhet gjatë

dhjetorit, por ata kanë propozuar dy data për fillimin e intervistimit, më 14 janar apo më 21 janar, prandaj, ne duhet të përcaktohem për datën e fillimit të intervistimit, tha kryetarja.

Muharrem Nitaj, theksoi se meqenëse partneri që është përfshirë në këtë proces e ka caktuar edhe metodologjinë e trajtimit të kësaj çështjeje, që kërkon shumë kohë, atëherë t'i kërkohej partnerit nga Ambasada britanike që t'i harmonizojë agjendat e veta dhe të jetë në funksion të agjendës së komisionit, e jo komisioni të përshtatet agjendës së tyre.

Pas diskutimeve, Komisioni vendosi që intervistimi i kandidatëve për anëtarë të Bordit të KOSTT-it të fillojë më 14 janar 2019.

Dardan Sejdiu, kërkoi nga administrata e Komisionit që të merret informacion nga Qeveria, se kur pritet të vijë në Kuvend Projektligji për ndërmarrjet publike, propozim ky që u përkrah nga Komisioni.

Mbledhja përfundoi në orën 11:40.

E përgatiti: Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Sala BERISHA SHALA